

Ne fokus/ Cana voton Frank Riberin per “Topin e Arte”

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 27 Nentor 2013 23:40



Lorik Cana ka votuar per “Topin e Arte” 2013. Kapiteni i Shqiperise ka zbuluar per mediat ne Itali se per cilin lojtar ka shkuar vota e tij. “Votova Riberine ne vend te pare, Ronaldon ne te dytin dhe Messin ne te tretin. Ronaldo e meriton gjithashtu çmimin. Ai ben gjera te jashtezakonshme, por Ribéry ka fituar gjithçka qe mund te fitohet ne sezonin e kaluar”, ka deklaruar Lorik Cana. Per Shqiperine ka votuar edhe trajneri Xhani De Biazi por ai akoma nuk e ka zbuluar emrin e lojtarit te tij te preferuar.